



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 26

Tiranë – E martë, 3 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11442, datë 27.2.2020	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2465
Udhëzim i Inspektoratit Qendror nr. 1, datë 25.2.2020	Për procedurën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë.. 2465
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 14.2.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’, të ndryshuar”..... 2470
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 117, datë 25.2.2020	Për miratimin e programit të rimëkëmbjes shëndetësore dhe sociale..... 2471
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 3, datë 25.2.2020	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2019–2020, sesioni i parë..... 2475
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 80, datë 28.2.2020	Për disa ndryshime në urdhrin 66, datë 24.2.2020, “Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, ‘Udha e Shkronjave’, Tiranë”..... 2476
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 22, datë 24.1.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 44, datë 14.10.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Vorë”..... 2477
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 27, datë 6.2.2020	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 5, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Pogradec”..... 2478
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 1054/11, datë 26.2.2020	Për shpronësimin dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik , për zonën 1/1, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin..... 2479

**DEKRET**

Nr. 11442, datë 27.2.2020

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Nimela Ramazan Biba
2. Lindita Ibrahim Veliqi (Skeja)
3. Alda Enver Hima (Balla)
4. Rajan Adi Hima
5. Mehmet Adi Hima
6. Sara Adi Hima
7. Adi Mehmet Hima
8. Ergys Ramiz Idrizi
9. Jon Ergys Idrizi
10. Elvis Sali Laukaj
11. Elsi Ilirjan Banushi
12. Ermelinda Emin Çaçi (Keli)
13. Henry Alfons Prelaj
14. Idri Llazar Tati
15. Erlind Selman Zhllima
16. Marinela Qamil Neusser (Tafa/Neußer)
17. Edlira Myftar Canaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM

Nr. 1, datë 25.2.2020

**PËR PROCEDURËN E TRAJNIMIT,
TESTIMIT FILLESTAR DHE PERIODIK,
SI DHE KRITERET PËRKATËSE TË
VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE
SHTETËRORË DHE VENDORË**

Në mbështetje të pikës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të germave “ë”, “f”, “g”, të pikës 2, të nenit 16 dhe pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, Inspektori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë,

UDHËZON:**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave për procedurën e trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, si dhe kriteret përkatëse të vlerësimit, për inspektorët shtetërorë dhe vendorë, të strukturave përgjegjëse sipas fushave të inspektimit, ku marrëdhëniet e punësimit të të cilëve janë të rregulluara me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

2. Ky udhëzim është i zbatueshëm për funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe të njëjësive të qeverisjes vendore.

3. Çdo inspektor shtetëror dhe vendor është i detyruar t’i nënshtrohet procedurës së trajnimit, testimit fillestar dhe periodik, sipas këtij udhëzimi.

4. Kjo procedurë synon aftësimin profesional të inspektorëve shtetërorë dhe vendorë, si dhe përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë,



sipas funksioneve dhe fushës së inspektimit ku ata veprojnë, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë inspektuese.

5. Ky proces përfshin trajnimin e detyrueshëm dhe testimin profesional fillestar përpara konfirmimit, në përfundim të kohës së provës, si dhe testimin periodik të inspektorëve. Në përfundim të trajnimit bëhet testimi me shkrim, në lidhje me njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.

6. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik, bëhen në bazë të një testimi me shkrim, që organizohet nga Inspektorati Qendror.

7. Objektivat kryesorë të këtij procesi janë:

a) përcaktimi i përshtatshmërisë së inspektorit me pozicionin e punës që ai mban;

b) zbulimi i aftësive të tij/saj për zhvillimin profesional;

c) përcaktimi i nevojave për trajnime shtesë.

8. Kësaj procedure i nënshtrohen:

a) inspektori/përgjegjësi i sektorit/drejtori i cili kryen funksione inspektimi, duke u grupuar sipas fushave të inspektimit;

b) kryeinspektori/kryeinspektori vendor /drejtuesi i degës territoriale/titullari i organit të varësisë apo njësisë, i strukturës përgjegjëse të inspektimit.

9. Inspektori/përgjegjësi i sektorit/drejtori i strukturës përgjegjëse të inspektimit, që kryen veprimtari inspektuese, më poshtë referohen me emrin “inspektor”, si për inspektorët shtetërorë ashtu edhe për inspektorët vendorë.

10. Detyrimeve ligjore të parashikuara në këtë udhëzim për inspektorin, i nënshtrohet edhe kategoria e përcaktuar në germën “b”, të pikës 8, të këtij kreu.

11. Moskalimi i testimit fillestar deri në përfundim të kohës së provës apo moskalimi në testimin periodik, për shkaqe që varen nga vetë inspektori, shkakton përkatësisht moskonfirmimin në fund të kohës së provës apo largimin nga detyra. Vendimi për largimin nga detyra, merret sipas procedurave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

12. Struktura përgjegjëse e inspektimit, kompetente për kryerjen e një funksioni inspektimi të parashikuar me ligj, pas miratimit nga Inspektorati Qendror, përcakton përputhshmërinë e kriterëve të pozicionit të punës së inspektorit, me fushën e inspektimit përkatës.

13. Struktura përgjegjëse e inspektimit shtetëror/vendor, brenda 2 (dy) ditëve pune nga emërimi në detyrë i inspektorit, njofton Inspektoratin Qendror, duke i vënë në dispozicion, në format elektronik dhe shkresor, të dhënat e dosjes lidhur me:

a) arsimimin;

b) kualifikimet;

c) përvojën në punë, nëse ka;

d) fotografi në formatin elektronik.

KREU II

ORGANIZIMI I TRAJNIMEVE

1. Inspektorati Qendror përgatit modulet e trajnimit dhe kualifikimit për legjislacionin bazë në fuqi për inspektimin, procedurat administrative, kundërvajtjet administrative, konfliktin e interesit, kodin e etikës, mbrojtjen e të dhënave personale, ligjet sektoriale, si dhe module të tjera.

2. Brenda muajit Mars të çdo viti, Inspektorati Qendror në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse të burimeve njerëzore të organit që kryen funksione inspektimi, harton programet e trajnimit sipas fushave përkatëse të inspektimit. Programet dhe mënyra e zhvillimit të tyre, miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.

3. Inspektorati Qendror, publikon në faqen zyrtare www.insq.gov.al, programin dhe periudhën e trajnimeve, sipas fushave të inspektimit.

4. Brenda muajit prill të çdo viti, Inspektorati Qendror dhe njësitë përgjegjëse të burimeve njerëzore, të organit që kryen funksione inspektimi, hartojnë listat e inspektorëve, që do t'i nënshtrohen kësaj procedure dhe bazuar në dosjet e tyre, si dhe përshkrimet e punës bëjnë ndarjen në grupe të përbashkëta.

5. Trajnimi duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe përditësimet, që i përkasin fushës së inspektimit dhe të lidhura me të.

6. Trajnimi organizohet sipas programit dhe afatit të miratuar, me specialistë të fushës të përcaktuar nga Inspektorati Qendror.

7. Inspektori që do t'i nënshtrohet trajnimit njoftohet nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku është punësuar, të paktën, 1 (një) muaj përpara datës së përcaktuar për fillimin e trajnimit.



8. Pjesëmarrja e inspektorit në trajnim është e detyrueshme, në masën 75 (shtatëdhjetë e pesë) për qind. Mosrespektimi i kësaj dispozite, sjell skualifikimin e inspektorit nga trajnimi.

9. Në rast skualifikimi, inspektori është i detyruar të ndjekë nga e para trajnimin.

10. Me përfundimin e trajnimit, inspektori i nënshtrohet testimit nga Komisioni i Vlerësimit Fillestar dhe Periodik (KVFP).

KREU III TESTIMI FILLESTAR

1. Inspektori në kohë prove, pasi ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm, i nënshtrohet procedurës së testimit fillestar, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Inspektorati Qendror në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të inspektimit, përcakton datën e testimit fillestar dhe njofton njësitë e burimeve njerëzore përkatëse, të paktën 1 (një) muaj përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e testimit.

3. Inspektorati Qendror publikon në faqen zyrtare dhe në sistemin elektronik “e-Inspektimi”, fushën e njohurive, bazën ligjore mbi të cilën do të zhvillohet testimi dhe materialet ose referencat përkatëse, të paktën 20 (njëzet) ditë pune, përpara zhvillimit të testimit.

4. Testimi fillestar i inspektorit realizohet nga KVFP-ja, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe sekretari, si më poshtë vijon:

a) 3 (tre) përfaqësues nga Inspektorati Qendror, ku njëri nga anëtarët kryeson komisionin;

b) 2 (dy) përfaqësues të strukturës përgjegjëse përkatëse të inspektimit.

5. Në rast se anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të këtij kreu, janë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të KVFP-së ose në mënyrë të pajustificuar, nuk marrin pjesë në KVFP, ata zëvendësohen me nëpunës të tjerë të të njëjtë institucion, nga organet e emërtesës.

6. Sistemi i vlerësimit bazohet në testimin me shkrim, i cili ka 100 pikë.

7. KVFP-ja, bazuar në fushën e njohurive për të cilat do të zhvillohet testimi, përgatit pyetjet për testimin me shkrim, për çdo fushë inspektimi, sipas rregullores së miratuar nga

Inspektori i Përgjithshëm, për metodologjinë e testimit.

8. KVFP-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga realizimi i testimit, nxjerr rezultatet. Inspektorati Qendror, brenda 2 (dy) ditëve pune, njofton njësinë përgjegjëse të burimeve njerëzore të strukturave përgjegjëse të inspektimit, rezultatit të testimit me shkrim sipas kësaj skeme:

a) 90–100 pikë, “shumë mirë”;

b) 70–89 pikë, “mirë”;

c) 51–69 pikë, “kënaqshëm”

ç) 0–50 pikë, “jokënaqshëm”.

9. Inspektori që është vlerësuar “shumë mirë”, konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e punës që ka dhe rekomandohet për ngritje në detyrë, në rast se aplikon në një procedurë të tillë konkurrimi.

10. Inspektori që është vlerësuar “mirë”, konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e punës ku është caktuar.

11. Inspektori që është vlerësuar “kënaqshëm”, konsiderohet i përshtatshëm për pozicionin e punës ku është caktuar, me kushtin që të ndjekë programe trajnimi të vazhdueshme, të cilat synojnë plotësimin e dobësive, që kanë shfaqur gjatë kësaj procedure.

12. Përcaktimi i fushave ku duhet të trajnohet inspektori, sipas pikës 11, të këtij kreu, bëhet nga KVFP, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të inspektimit. Ndjekja e programeve vazhduese, duhet të realizohet brenda një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare), nga përfundimi i procedurës së testimit fillestar.

13. Programi i trajnimit, për inspektorin e përcaktuar në pikën 11, të këtij kreu, hartohet nga Inspektorati Qendror, bazuar në raportin e KVFP-së dhe në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të inspektimit.

14. Inspektori që është vlerësuar “jokënaqshëm”, konsiderohet jo i përshtatshëm për pozicionin e punës ku është caktuar. Moskalimi i testimit fillestar deri në përfundim të kohës së provës, për shkaqe që varen nga vetë inspektori, shkakton moskonfirmimin në fund të kohës së provës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

15. Mosparaqitja e inspektorëve në testimin fillestar, pa shkaqe të arsyeshme, sjell moskonfirmimin, në fund të kohës së provës.



16. Në kuptim të pikës 15, të këtij kreu, shkaqe të arsyeshme, konsiderohen:

- a) martesë e inspektorit apo të fëmijës së tij;
- b) lindja e fëmijës për baballarët;
- c) vdekja e prindërve, gjyshërve, të bashkëshortit, të fëmijës, të vëllezërve, të motrave;

d) sëmundja e rëndë e fëmijës, prindërve apo bashkëshortit, të vërtetuara me raport mjekësor;

e) rastet e trajnimit jashtë vendit, me miratim të strukturës përgjegjëse të inspektimit.

17. Në rast të mosparaqitjes në testimin fillestar, për një nga shkaqet e arsyeshme në pikën 16, të këtij kreu, inspektori do t'i nënshtrohet procedurës së testimit fillestar, brenda 1 (një) muaji nga data e rikthimit në punë.

KREU IV

TESTIMI PERIODIK DHE INTERVALET

1. Inspektori e strukturës përgjegjëse të inspektimit do të testohet periodikisht nga Inspektorati Qendror, sipas procedurave dhe kriterëve përkatëse të vlerësimit, të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Intervali i testimit periodik për inspektorin, që ka kaluar testimin fillestar, realizohet çdo 4 (katër) vjet.

3. KVFP-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, nga realizimi i testimit periodik, nxjerr rezultatet sipas skemës së përcaktuar në pikën 8, të kreut III.

4. Në fund të testimit periodik, Inspektorati Qendror vërteton:

- a) përmbushjen e kërkesave të testimit dhe vazhdimësinë në detyrë të inspektorit ose;
- b) moskalimin e testimit periodik, i vlerësuar “jokënaqshëm”.

5. Në rastin e parashikuar në germën b, të pikës 4, të këtij kreu, inspektori i nënshtrohet procedurës së trajnimit të detyrueshëm dhe ritestimit, brenda 6 (gjashtë) muajve.

6. Moskalimi i testimit periodik sipas pikës 5, të këtij kreu, shkakton largimin nga detyra të inspektorit, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin.

7. Inspektorati Qendror, bazuar në informacionin e dorëzuar nga struktura përgjegjëse e inspektimit, është përgjegjës për njoftimin e të gjithë inspektorëve, të cilët duhet t'i nënshtrohen testimit periodik.

8. Mosparaqitja e inspektorëve në testimin periodik, pa shkaqe të arsyeshme, konsiderohet si shkelje dhe përbën shkak për largim nga detyra.

9. Në kuptim të pikës 8, të këtij kreu, shkaqe të arsyeshme konsiderohen shkaqet e përmendura në pikën 16, të kreut III, dhe i nënshtrohen testimit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga rikthimi në punë.

10. Në rast të mosrespektimit të detyrimit, të përcaktuar për testimin periodik, për një nga shkaqet e arsyeshme, inspektori është i detyruar të ndjekë trajnimin përkatës, brenda 3 (tre) muajve nga data e rikthimit në punë.

11. Procedurës së testimit periodik nuk i nënshtrohen inspektorët, të cilët janë në 5-vjeçarin (pesëvjeçarin) e fundit, para daljes në pension.

KREU V

PROCEDURA E TESTIMIT

1. Testimi garanton uniformitet në vlerësimin profesional të inspektorit, në nivel kombëtar, përmes verifikimit të aftësive të nevojshme profesionale, sipas specifikave të çdo fushe inspektimi.

2. Përmbajtja e testimit duhet të hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, procedurat administrative, kundërvajtjet administrative, konfliktin e interesit, kodin e etikës, mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjeve sektoriale, për çdo strukturë përgjegjëse inspektimi.

3. Testimi organizohet dhe zhvillohet nga Inspektorati Qendror, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse inspektuese, që mbulon fushën përkatëse të inspektimit.

4. Struktura përgjegjëse njofton menjëherë Inspektoratin Qendror, për inspektorët, të cilët nuk kanë kryer testimin periodik për shkak të gjendjes në kushtet e përcaktuara në pikën 16, të kreut III, të këtij udhëzimi.

5. Inspektorati Qendror në bashkëpunim me njësitë e burimeve njerëzore të strukturave përgjegjëse të inspektimit, përcakton kalendarin e zhvillimit të testimit, fushat e legjislacionit të cilat kanë pësuar ndryshime, si dhe të gjitha ndryshimet përkatëse, brenda muajit shkurt të çdo viti. Pranimi i inspektorëve në testim, bëhet vetëm nga Inspektorati Qendror.

6. Inspektorati Qendror njofton me shkrim strukturat përgjegjëse të inspektimit, për listat



përkatëse me inspektorët që duhet të paraqiten për kryerjen e testimit. Njoftimi kryhet jo më vonë se 1 (një) muaj, përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e testimit.

7. Testimi organizohet sipas kalendarit të miratuar nga Inspektorati Qendror.

8. Programi orientues i testimit, bëhet i njohur nga Inspektorati Qendror për inspektorët përkatës jo më vonë se 1 (një) muaj, përpara testimit.

9. Testimi zhvillohet me shkrim, në datat e përcaktuara nga Inspektorati Qendror.

10. Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të testimit, bëhet sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Metodologjinë e Testimit.

11. Inspektorati Qendror, për zhvillimin e testimit:

a) harton modulet e trajnimit dhe testimit;
b) trajnon personelin organizues dhe mbikëqyrës të testimit, kur ata nuk janë pjesë e stafit të Inspektoratit Qendror;

c) publikon *online* programin orientues të testimit;

d) harton grafikun, shpërndan dhe publikon listat e inspektorëve, sipas datës dhe qendrave të testimit;

e) krijon, arkivon dhe administron bazën elektronike të të dhënave;

f) verifikon identitetin dhe numrin e regjistrimit të kandidatëve pjesëmarrës në qendrën/qendrat e testimit;

g) siguron kushte të përshtatshme në qendrën/qendrat e testimit për zhvillimin e testimit;

h) njofton inspektorin për rezultatet e testimit, në adresën e tij/saj elektronike.

12. Hartimi i pyetjeve të testimit janë kompetencë e KVFP-së. Ato synojnë të vlerësojnë njohuritë e përgjithshme të inspektorit, për procedurat e inspektimit dhe legjislacionin sektorial.

13. Pyetjet janë të njëjta për të gjithë inspektorët e të njëjtës fushë.

14. KVFP-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga përfundimi i testimit, kryen vlerësimin.

15. Nëse gjatë korrigjimit të testeve, konstatohen gabime në pyetje, këto pyetje nuk merren parasysh. Në këtë rast ulet edhe numri maksimal i pikëve. Vlerësimi fillon nga ky numër i zvogëluar i pikëve. Zvogëlimi i pikëve nuk duhet të

jetë në disavantazh, qoftë edhe të një inspektori të vetëm.

16. Administratori/ët, kanë të drejtë, që në rast se evidentohen shkelje të rënda, të rregullave të testimit, t'i propozojë KVFP-ja vlerësimin e inspektorit që thyen rregullat, me vlerësim negativ. Vlerësimi negativ gjatë realizimit të testimit, pasqyrohet në procesverbal, për shkeljet e konstatuara, nga administratori/ët dhe shoqërohet me zbritjen e 5-20 pikëve.

17. Testimi me shkrim vlerësohet si i kryer me sukses, nëse kandidati merr më shumë se 50 pikë nga 100 të mundshme.

18. Inspektorati Qendror ia përcjell strukturës përkatëse të inspektimit, listën e rezultateve të testimit, ku përfshihen:

a) pikët e testimit;
b) kufiri i kalimit me sukses.

19. Procesverbali i rezultateve firmoset nga të gjithë anëtarët e KVFP-së.

20. Inspektorati Qendror mban një bazë të dhënash në sistemin elektronik “e-Inspektimi”, për të gjitha testimet e kryera.

KREU VI VLERËSIMI I TESTIMIT

1. Testimi periodik cilësohet i kryer me sukses, nëse në testim inspektori është vlerësuar së paku me vlerësimin “kënaqshëm”. Inspektori i vlerësuar me vlerësimin “jokënaqshëm”, i nënshtrohet një trajnimit të detyrueshëm dhe në përfundim kryen testimin.

2. Nëse një inspektor nuk paraqitet në testim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë testimi nuk vlerësohet si i kryer.

3. Tërheqja nga testimi nuk mund të kryhet pas marrjes së testit.

4. Inspektori ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të ankimojë nëse ka kontestime për rezultatit. Inspektori paraqet kërkesën ankimore me shkrim, pranë Inspektoratit Qendror, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e rezultateve.

5. Inspektorati Qendror, nëpërmjet një komisioni *ad-hoc*, që ngrihet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, shqyrton kërkesën ankimore dhe kthen përgjigje të argumentuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike. Në rastet kur komisioni *ad-hoc* sugjeron rivlerësimin e rezultatit, kërkohet mendimi i KVFP-së.



6. Rezultati i komisionit *ad-hoc* është vendim përfundimtar dhe mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, brenda 45 (dyzet e pesë ditëve) nga marrja dijeni.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

1. Çdo inspektor, i cili është në marrëdhënie pune, të rregulluara sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, pranë strukturës përgjegjëse për inspektimin, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, do t'i nënshtrohet testimit fillestar dhe periodik të organizuar nga Inspektorati Qendror.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, ngarkohet Inspektorati Qendror për hartimin e Rregullores për Metodologjinë e Testimit, e publikon në faqen zyrtare www.insq.gov.al dhe e dërgon për njohje, pranë strukturave përgjegjëse të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

UDHËZIM
Nr. 7, datë 14.2.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5222, DATË 26.6.2015, “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 926, DATË 29.12.2014, ‘PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PROCEDURËN E SHITJES’, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si në zbatim të pikës 14, kreu IV, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes” të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5222, datë 26.6.2015, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes’, të ndryshuar”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Pika 6 e udhëzimit, paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Në rastin e vlerësimit të objekteve që do të përfshihen në fondin e kompensimit fizik për ish-pronarët, pagesa e ekspertëve do të bëhet sipas procedurës së mësipërme. Pagesa në të dyja rastet e mësipërme do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.”.

2. Pika 11.3 e udhëzimit, paragrafi i katërt riformulohet si më poshtë:

“- të marrë vendim lidhur me dokumentacionin e vlerësimit, sipas pikës 11.2 të këtij udhëzimi”.

3. Pika 13 e udhëzimit riformulohet si më poshtë:

“Pas administrimit të dokumentacionit të vlerësimit të pronës së dërguar nga dega e shoqërive publike në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, strukturat përkatëse për privatizimin e pronës shtetërore të kësaj të fundit, kryejnë verifikimin, nëse ky dokumentacion ka kaluar në hallkat përkatëse, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes’, të ndryshuar, si dhe në këtë udhëzim dhe, nëse e gjejnë atë të rregullt, përgatitin praktikën përkatëse për ta përcjellë atë pranë Komisionit të Shqyrtimit dhe Transparencës, për verifikimin, konfirmimin dhe transparencën e procedurës së ndjekur.”.

4. Pika 23 e udhëzimit riformulohet si më poshtë:

“Në zbatim të pikave 4 dhe 6, të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes’ të ndryshuar, me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, mund të përdoren edhe forma të tjera publikimi në medien televizive, të shkruar, postera etj. Shpenzimet e



publikimit do të përballohen nga shpenzimet buxhetore të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.”.

5. Pika 35 e udhëzimit, paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Në zbatim të pikave 3, 4, të kreut I dhe të pikës 25, të kreut III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes’, të ndryshuar, shpenzimet që lidhen me privatizimin, përkatësisht për:

i. pagesën e ekspertëve vlerësues, kontabël dhe ekspertë të tjerë të fushave përkatëse, që përzgjidhen nga ministri përgjegjës për ekonominë për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet; dhe

ii. për përballimin e të gjitha shpenzimeve të tjera që lidhen me procesin e privatizimit të pronës shtetërore,

përballohen nga shpenzimet buxhetore të ministrisë përgjegjëse për ekonominë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM
Nr. 117, datë 25.2.2020

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
RIMËKËMBJES SHËNDETËSORE
DHE SOCIALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’”,

UDHËZOHJ:

1. Miratimin e programit të rimëkëmbjes shëndetësore dhe sociale dhe planit të masave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimin e programit të rimëkëmbjes shëndetësore dhe sociale dhe planit të masave nga

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

PROGRAMI
**PËR RIMËKËMBJEN SHËNDETËSORE
DHE SOCIALE DHE PLANI I MASAVE**

I. SEKTORI I SHËNDETËSISË

Sektori i shëndetësisë në Shqipëri ka evoluar gjatë tri dekadave të fundit kryesisht në sistemin publik dhe i fokusuar në forcimin e kujdesit shëndetësor parësor. Disa institucione shëndetësore kryesore që funksionojnë në nivel kombëtar koordinohen përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) si Instituti i Shëndetit Publik (ISHP); Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH); Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH) dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror (ISHSH).

Sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore publike, ato bazohen në shërbime të promocionit dhe promovimit shëndetësor, parandalimit, diagnostikimit të hershëm, trajtimit dhe rehabilitimit. Sektori privat mbulon kryesisht shërbimin farmaceutik dhe dentar, funksionimin e disa klinikave të specializuara për diagnostikim dhe spitale. Shërbimet e kujdesit shëndetësor publik janë të organizuara në tri nivele: kujdesi shëndetësor parësor i ofruar në 413 qendra shëndetësore dhe poliklinika; kujdesi shëndetësor sekondar i siguruar në spitalet e rretheve (51 spitale në 36 rrethe) dhe kujdesi shëndetësor terciar që ofrohet në Qendrat Spitalore Universitare në Tiranë.

Përforcimi i vazhdueshëm i sektorit të shëndetësisë bëhet në përputhje me përparësitë strategjike kombëtare të përshkruara në Strategjinë Kombëtare të Shëndetit në Shqipëri, 2016–2020.

Për të mbështetur zbatimin e rimëkëmbjes, MSHMS-ja zhvilloi vizionin dhe principet e mëposhtme:



Rivendosjen e kapaciteteve të ofrimit të shërbimeve për të reduktuar sa më shumë ndërprerjen e mundshme për aksesin në shërbime, në veçanti për grupet vulnerabël, si: fëmijët, gratë shtatzëna, gratë gjdhënëse, të moshuarit dhe pacientët me sëmundje kronike, dhe;

Përdorimi i rimëkëmbjes nga pasojat e tërmetit, të konsiderohet si mundësi për të rritur qëndrueshmërinë e sistemit shëndetësor dhe përshpejtuar e modernizuar ofrimin e shërbimeve në zonat e prekura. Ekziston një nevojë urgjente për të ndërtuar aftësi midis partnerëve të sektorit shëndetësor, për të reaguar sa më mirë në përballimin e një emergjence, si dhe për të siguruar që shërbimet themelore, përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, të adresohen nga kujdesi shëndetësor parësor për një afat më të gjatë.

1. Vëmendje e veçantë për të adresuar rreziqet e mundshme të rritura të shëndetit dhe pengesat për të hyrë në shërbime të lidhura me gjininë, moshën, gjendjen socioekonomike, kulturën, besimin dhe/ose vendndodhjen gjeografike;

2. Përdorimi i rikuperimit për të mbështetur ambiciet dhe sfidat për reformimin e vazhdueshëm të sektorit shëndetësor, kur është e nevojshme, përfshirë zbatimin e modeleve të reja të kujdesit, që do të çojnë në rritjen e efikasitetit dhe adresimin e ndryshimeve të nevojshme për shërbim shëndetësor;

3. Vëmendje e veçantë për të siguruar që të gjithë profesionistët shëndetësorë janë të trajnuar për parandalimin e dhunës seksuale dhe përgjigjen ndaj nevojave të të mbijetuarve;

4. Ndërtimi mbi partneritetet ekzistuese si ato kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe përshtatja e investimeve në vazhdim për të mbështetur rimëkëmbjen dhe aftësinë e sistemit shëndetësor;

5. Ndërtimi i kapaciteteve të komunitetit për të zvogëluar rreziqet dhe forcuar gatishmërinë e komunitetit, duke përfshirë adresimin profesional të çrregullimit të stresit post traumatik.

Koordinimi dhe zbatimi i planit të rimëkëmbjes do të jetë përgjegjësi e “Komisionit të përgatitjes dhe reagimit të emergjencave civile”, i udhëhequr nga zëvendësministri i Shëndetësisë.

Rehabilitimi dhe ndërtimi i objekteve shëndetësore të dëmtuara plotësisht është planifikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2020.

Rindërtimi dhe riparimi i ambienteve shëndetësore do të shoqërohet me standardizim dhe modernizim të pajisjeve, sistemeve të komunikimit dhe mobilimit.

Gjatë rimëkëmbjes së Shqipërisë nga tërmeti, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimit të burimeve njerëzore mbi elementet e sigurisë shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve. Trajnimi do të jetë pjesë e një programi pune për gatishmërinë dhe reagimin ndaj urgjencave. Masat për t'i bërë spitalet dhe objektet e tjera shëndetësore të sigurta dhe operative para, gjatë dhe pas katastrofave do të mbeten prioritet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Programi i Spitaleve të Sigurta është të vazhdojë të ofrojë shërbime të kujdesit shëndetësor në raste emergjencash dhe katastrofash. Kjo do të mundësojë që spitalet të vazhdojnë të funksionojnë dhe të ofrojnë nivele të përshtatshme dhe të qëndrueshme të kujdesit shëndetësor gjatë dhe pas urgjencave apo katastrofave; për të mbrojtur punonjësit e shëndetit, pacientët dhe familjet; për të mbrojtur integritetin fizik të ndërtesave spitalore, pajisjet dhe sistemet kritike spitalore dhe për t'i bërë spitalet të sigurt dhe elastik ndaj rreziqeve të ardhshme, përfshirë ndryshimin e klimës.

Mbi të gjitha, për të ulur rrezikun dhe për të rritur rezistencën e spitaleve, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sigurimit jo vetëm të sigurisë fizike, por edhe të rritjes së gatishmërisë për emergjencat e ardhshme. Një pjesë e rëndësishme e këtij programi do të jetë zhvillimi i aftësive të tyre të gatishmërisë në nivelin spitalor.

Për të forcuar kapacitetin kombëtar për t'u përgatitur dhe për t'iu përgjigjur një ngjarje të shëndetit publik, është thelbësore të kemi një qendër funksionale të operacioneve të urgjencës shëndetësore publike që rrit sistemet e paralajmërimit të hershëm, mbështet koordinimin efektiv të përgjigjeve dhe rrit komunikimin në kohë reale në të gjitha nivelet të sistemit shëndetësor kombëtar.

MSHMS-ja, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, ka vendosur të vlerësojë reagimin e sektorit shëndetësor ndaj fenomeneve të ngjashme. Ky aktivitet shumësektorial, multiinstitucional dhe shumëdisiplinor do të rishikojë të gjitha veprimet e ndërmarra nga shërbimi shëndetësor do të vlerësojë aftësinë funksionale të sektorit shëndetësor në reagimin ndaj urgjencës dhe do të identifikojë fushat për përmirësim të vazhdueshëm

II. SEKTORI SOCIAL

Sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri kombinon pagesat në *Cash* (ndihmë ekonomike



dhe përfitime të aftësisë së kufizuar) me programet e kujdesit (shërbime të kujdesit shoqëror), duke integruar masa për të fuqizuar dhe për të mbështetur njerëzit që jetojnë në varfëri, njerëzit me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit, të rinjtë, pakicat etnike dhe kategoritë e tjera vulnerabël.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave të mbrojtjes sociale. Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është agjencia ekzekutive përgjegjëse për administrimin e programeve të pagesave në politikën e mbrojtjes sociale, të dorëzuara përmes qeverisjes lokale; institucion monitorimi dhe ankimimi për shërbime të përkujdesjes shoqërore, si dhe shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shoqëror në shkallë kombëtare. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) është institucioni kryesor për koordinimin e mbrojtjes sociale dhe përgatitjen e reagimit të emergjencave shëndetësore, si edhe pjesë e Komitetit Ndërmintor për Emergjencat Civile. Në nivelin rajonal dhe lokal, koordinimi i përgjigjes ndaj emergjencave ose katastrofave bëhet me Drejtoritë Rajonale për Shërbimet Sociale dhe bashkitë. Ministria udhëheq dhe koordinon mbështetjen e dhënë nga organizatat jofitimprurëse, kombëtare dhe ndërkombëtare, në përgjigje të komuniteteve të prekura nga një katastrofë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mobilizoi drejtoritë rajonale të shërbimeve sociale, Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe bashkëpunoi ngushtë me bashkitë për të vlerësuar nevojat e menjëhershme. U mobilizuan menjëherë për të siguruar mbështetje nën koordinimin e MSHMS-së, rreth 260 psikologë që ishin të gatshëm për t'u mobilizuar përmes Urdhrit të Psikologut dhe u dërguan për të dhënë, për të asistuar në zonat e prekura. 274 punonjës socialë dhe psikologë shtesë (gjithsej 534) dhe mbi 300 vullnetarë u angazhuan, gjithashtu, përmes organizatave të shoqërisë civile. Ekipet e angazhuara kanë raportuar dhe bashkërenduar punën, duke diskutuar mbi nevojat dhe duke planifikuar ndërhyrjet dhe zonat e punës, në përpjekje për të siguruar mbulim më të mirë të shërbimeve dhe për të shmangur mbivendosjet e shërbimeve. Vëmendje e veçantë u jepet personave

të zhvendosur, personave me sëmundje kronike, fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Ngjarja e 26 nëntorit nxori në pah nevojën për shërbime më të mira sociale dhe për një sistem funksional vlerësimi dhe referimi, i cili lidhet dhe ndërvepron me programet e mbështetjes financiare.

Ky dokument përqendrohet kryesisht në dy drejtime kryesore: uljen e rrezikut dhe rritjen e aftësisë rikuperuese të popullatës, me vëmendje të veçantë për grupet vulnerabël dhe minoritetet, si dhe gatishmërinë e sistemit të mbrojtjes sociale.

Gjetjet dhe veprimet e propozuara për vlerësimin e nevojave në sistemin e mbrojtjes sociale, kapacitetet e gatishmërisë dhe nevojat e veçanta të popullatës, do të harmonizohen me politikën kornizë kombëtare të mbrojtjes sociale.

Vëmendje do t'i kushtohet krijimit të një kornize emergjente për mbrojtje sociale, për t'iu përgjigjur nevojave të komuniteteve në nevojë, me plane të qarta afatmesme dhe afatgjata, role dhe përgjegjësi të përcaktuara mirë për secilin prej subjekteve të përfshirë, si dhe protokolle përgjigjeje dhe mekanizma koordinimi që aplikohen menjëherë pas një emergjence. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe sigurimit, që masat të adresojnë të gjitha komunitetet dhe të përqendrohen në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve në raste urgjente dhe pas urgjencës, veçanërisht ato me rreziqe të tjera më të mëdha të cenueshmërisë, si: paaftësia, sëmundjet kronike, komunitetet e marginalizuara, fëmijët pa kujdes prindëror etj. Integrimi i punës dhe mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve të tjerë, gjithashtu, do të jenë pjesë e rëndësishme e gatishmërisë së urgjencës.

Për më tepër, ky dokument duhet të sigurojë kornizën konceptuale për krijimin e një standardi kombëtar të përcaktuar të mbrojtjes sociale, bazuar, në të cilin politikat dhe planet operationale të mbrojtjes sociale udhëhiqen nga gjithëpërfshirja dhe një qasje e përkrahjes së mbrojtjes sociale të ciklit të jetës.

Një pjesë e gatishmërisë së emergjencës, gjithashtu, do të përfshijë një sistem paralajmërimi të hershëm dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore për mbrojtjen sociale mbi elementet e sigurisë njerëzore dhe ofrimin e shërbimeve për grupe të ndryshme të popullsisë. Kjo nënkupton edhe protokollet e hollësishme të punës me grupe



të ndryshme në nevojë dhe vulnerabël në një situatë katastrofe.

Shërbimet psikosociale. Shërbimet e këshillimit dhe nevoja për mbështetje psikosociale ishin një nga nevojat kryesore të identifikuara për të gjithë popullatën e prekur, por, veçanërisht, për fëmijët. Kthimi në normalitet është i domosdoshëm ndërsa sistemi i mbrojtjes sociale dhe strukturat e ofrimit të shërbimeve duhet të përgatiten më mirë në adresimin e nevojave pas katastrofës. Ky shërbim duhet të jetë i koordinuar edhe me sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, ndërsa ekupe të lëvizshme të psikologëve mund të angazhohen për njësitë administrative/bashkitë e prekura ku ata mund të ofrojnë mbështetje gjatë periudhës afatshkurtër, ku gjashtë muajt e parë janë më intensivët.

Rritja e aftësisë rikuperuese të komunitetit, përmes forcimit të komuniteteve për t'u bërë elastik

ndaj katastrofave, është pjesë e programit të rimëkëmbjes, e cila mund të zhvillohet së bashku me shkollat, qendrat komunitare, me qëllim bashkimin e njerëzve dhe forcimin e rrjeteve të sigurisë së komuniteteve.

Shërbime për personat me aftësi të kufizuara në zonat e prekura. Nevojat janë shumë më të larta për këto shërbime, së bashku me kapacitetet njerëzore që punojnë me kategoritë vulnerabël, pas ngjarjes së tërmetit.

Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve: Kapacitetet e ofruesve të shërbimeve publike dhe jopublike do të fuqizohen, fillimisht me një përqendrim në zonat e prekura dhe situatat pas katastrofës.

PLANI I MASAVE PËR RIMËKËMBJEN SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

LLOJI I NDËRHYRJES (MASA)	Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
SEKTORI SHËNDETËSOR			
RIKONSTRUKSIONI I ASETEVE FIZIKE DHE NDËRTIMI ME CILËSI			
Nevojat për rindërtim, përfshirë ndërtimin me cilësi dhe modernizimin; kujdesi shëndetësor terciar			
Nevojat për rindërtim, përfshirë ndërtimin me cilësi dhe modernizimin; kujdesi shëndetësor dytësor			
Nevojat për rindërtim, përfshirë ndërtimin me cilësi dhe modernizimin; kujdesi shëndetësor parësor			
RIMËKËMBJA DHE RIKUPERIMI. RIVENDOSJA E DHËNIES SË SHËRBIMEVE, REDUKTIMI I RISKUT DHE RITJJA E AFTËSISË RIKUPERUESE QEVERISËSE			
Shembja dhe heqja e rrënojave			
Menaxhimi i strukturave shëndetësore të përkohshme (kapacitetet shtesë të shërbimit për çadrat/hotele)			
Kostot e qirasë për strukturat e përkohshme shëndetësore			
Trajtimi i personave të dëmtuar			
Rehabilitimi i pacientëve me aftësi të kufizuara për shkak të traumës			
Mbulimi i kostove të rritura të transportit me autoambulancë			
Trajtimi dhe kujdesi për numrin e shtuar të pacientëve me probleme të shëndetit mendor dhe/ose psikologjike			
Sigurimi i trajtimit të vazhdueshëm për të sëmurët kronikë të zhvendosur në çadra/hotele.			
Përfshirja nga tarifat e shërbimit shëndetësor (përfshirë diagnostikimin dhe mjekimin), për pacientët që kanë humbur të ardhurat dhe/ose të zhvendosur			
Ofrimi i shërbimit falas nga institucionet shëndetësore private për të prekurit nga tërmeti			
Kostoja për koordinimin dhe menaxhimin e fatkeqësive			
Kostoja për sistemet e paralajmërimit dhe survejancës ndaj tërmeteve			
Promocioni shëndetësor dhe fushatat e ndërgjegjësimit publik për të adresuar riskun ndaj shëndetit			



Fushata vaksinimi dhe imunizimi (p.sh., gripi)			
NEVOJAT PËR RIKUPERIM			
Programi spitale të sigurt: vlerësim dhe trajnim			
Trajnime në vendin e punës për stafet e spitaleve të rikonstruara me standarde moderne, përshtatja me modelet e reja të kujdesit			
Qendra Operacionale e Emergjencave të Shëndetit Publik			
Investimet fillestare për përmirësimin e modelit të koordinimit për Qendrën Operacionale të Emergjencave Shëndetësore, përgatitjen dhe planin e kontingjencave ndaj tërmeteve			
Investim fillestar, skuadrat e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore			
SEKTORI SOCIAL			
RIMËKËMBJA			
Ofrimi i shërbimeve psikologjike, përmes skuadrave lëvizëse në zonat e prekura			
Shërbime rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara			
Sigurimi i vlerësimit të efekteve dhe të nevojave të komunitetit të prekur			
Zhvillimi i një kuadri emergjence për mbrojtjen sociale – përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për çdo aktor			
Përmirësimi dhe zhvillimi i një kuadri konceptual, duke përcaktuar standardin e shërbimeve sociale			
Rishikimi dhe forcimi i SMI-së për sistemin e mbrojtjes sociale dhe forcimi i kapaciteteve të stafit			
Rritja e bashkëpunimit me pushtetin lokal			
Rritja e ndërgjegjësimit mbi shërbimet ekzistuese mbështetëse dhe të drejtën e aksesit në shërbime			
RIKUPERIMI			
Vlerësimi i nevojave të reduktimit të riskut për mbrojtjen sociale, përfshirë kuadrin ekzistues ligjor për forcimin dhe sigurimin e sigurisë në objektet e shërbimeve të kujdesit shoqëror (përfshirë konsultimet dhe trajnimet)			
Protokollet e reagimit emergjent për stafin që punon me grupe të ndryshme në situatë katastrofe. Zhvillimi i protokolleve për 4 kategori (fëmijë, gra, PAK dhe minoritetet)			
Zhvillimi i programeve për riaftësimin e komunitetit.			
Fuqizimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale			

UDHËZIM

Nr. 3, datë 25.2.2020

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI
SHKOLLOR 2019–2020, SESIONI I PARË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë (sesioni i parë), për vitin shkollor 2019–2020, do të zhvillohen si më poshtë:

- a) gjuhë e huaj, më 16 qershor 2020;
- b) gjuhë shqipe, më 19 qershor 2020;
- c) matematikë, më 23 qershor 2020.

2. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë.

3. Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar, janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Testi i gjuhës së huaj



hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

4. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

5. Provimet kombëtare të arsimit bazë fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.

6. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në gjuhën amtare. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare” do të zhvillohet më 12 qershor 2020.

7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke ndiqet procedura si vijon:

a) testi përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Fier;

b) mësuesit dhe pedagogët që hartojnë testin, propozohen nga ZVAP-të Gjirokastrë-Libohovë-Dropull, Delvinë-Finiq dhe Sarandë-Konispol;

c) grupi që përgatit testin mblidhet në ZVAP-në Gjirokastrë-Libohovë-Dropull;

ç) testi tërhiqet në ZVAP Gjirokastrë-Libohovë-Dropull;

d) përfaqësuesit e ZVAP-së Delvinë-Finiq dhe ZVAP-së Sarandë-Konispol e tërheqin testin në ZVAP-në Gjirokastrë-Libohovë-Dropull, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP-së Gjirokastrë-Libohovë-Dropull e tërheqin testin në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase ndiqet procedura si vijon:

a) testi përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë;

b) grupi që përgatit testin mblidhet në DRAP-në Korçë;

c) testi tërhiqet në DRAP Korçë;

ç) përfaqësuesit e ZVAP-së Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, drejtorja e këtij instituti tërheq testin në QSHA, një ditë para zhvillimit të

provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit *Braille*.

11. Nxënësi mbetet në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën t’i japë ato në sesionin e dytë, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.

12. Sektori i kurrikulës, i Zhvillimit Profesional në ZVAP, merr nga Qendrat e Vlerësimit të Testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së, në QSHA dhe DPAP.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 80, datë 28.2.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
66, DATË 24.2.2020, “PËR MBYLLJEN E
VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT,
‘UDHA E SHKRONJAVE’, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikave 3 dhe 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Në fund të pikës 1, të urdhrit nr. 66, datë 24.2.2020, shtohet togfjalëshi "... në përfundim të vitit shkollor 2019–2020".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, "Udha e Shkronjave", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

VENDIM
Nr. 22, datë 24.1.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 44, DATË 14.10.2016,
"PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME VORË"**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

**KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,**

në mbledhjen e datës 24.1.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e

projektvendimit "Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 44, datë 14.10.2016 "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë (UK Vorë), me shkresën nr. 4 prot. ERRU, datë 7.1.2020, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 44, datë 14.10.2016 "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vorë sh.a. z. Donald Mezin, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,



VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: z. Donald Mezini”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 27, datë 6.2.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 5, DATË 3.2.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJIELLËS-
KANALIZIME POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.2.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec (UK Pogradec), me shkresën nr. 43 prot., datë 23.1.2020, me lëndë “Shkresë përcjellëse” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të

Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Pogradec, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Pogradec me vendimin nr. 5, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Pogradec sh.a., z. Johan Sterjo, ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në degën Histori.

5. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Pogradec sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Pogradec është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 5, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor: z. Johan Sterjo”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

**KËRKESË****Nr. 1054/11, datë 26.2.2020****PËR SHPRONËSIMIN DHE/OSE PËR
SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR
INTERES PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësimin dhe/ose për shkëmbimin e pronës, për interes publik, për zonën 1/1, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Enti Kombëtar i Banesave.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur si:

1. Për pasurinë e llojit “truall”, është bërë bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

2. Për pasurinë e llojit “tokë arë”, është bërë bazuar në shkresën nr. 2135/1, datë 20.2.2020, “Kthim përgjigje”, të Agjencisë së Trajtimit të Pronave;

3. Për “kulturat bujqësore” është bërë në referencë të udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000, “Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes”;

4. Për pasuritë e llojit “ndërtesë”, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret

teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, së ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) me funksion “banimi” është bërë bazuar në shkresën nr. 674/2, datë 6.2.2020, të ASHK-së, Kurbin;

b) me funksion “njësi socio-ekonomike”, do të llogaritet me situacion, në proces vlerësimi nga EKB-ja, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse, pranë Entit Kombëtar të Banesave, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësimin dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit, është me vlerë totale paraprake të kompensimit nga shpronësimi në shumën 20 207 379 (njëzetë milionë e dyqind e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, si dhe me sipërfaqe totale paraprake të shkëmbimit 2 711.93 (dy mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e tre) m².

ZËVENDESMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE SHKËMBEHEN, PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "ZONË TË RE PËR ZHVILLIM", NË ZONËN 1/1, NJËSIA ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)			VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË													VLERA TOTALE (leke)	Kompensim (leke) Shëmbim m ²	SHËNIME			
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. pas	Lloji	Sip.	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"				Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi					Vlera e kulturës bujësore dhe druftorë		
							Totale	Sip.	Çmimi	Vlera	Sip.				Çmimi	Vlera	Sip. ndërt.	Çmimi mes.	Vlera				Sip. nd.	Vlera	Vlera e kulturës bujësore dhe druftorë
							(m ²)	(m ²)	(lekë/m ²)	(leke)	(m ²)				(lekë/m ²)	(leke)	konf.	sh/blejeve	(leke)				konf.ng a	sipas	Vlera e kulturës bujësore dhe druftorë
																	ASHK	sipas ZVRPP- së					ASHK	Preventi vit	
																	(m ²)	(lit ³)					(m ²)	(leke)	
PRONE PRIVAT																									
1	Ndue	Pashk	Suti	2364	3/714/ND	Ndërtesë	325.28							325.28	27.863	9,063,276.64				9,063,276.64	Shëmbim	Konfirmuar nga ASHK-ja, 6.2.2020.			
2	Agostin	Preng	Bardhi	2364	4/801	Truall	5.808				618	1.620	1,001,160.0							1,001,160.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 6.2.2020.			
3	Vlash	Nikoll	Suti	2364	3/720/2	Arë	600	600	321	192,600			-						167,326	359,926.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
4	Emiljan Genti Anila Frango	Lek Lek Lek Kol	Suti Suti Vela Suti	2364	3/714/1	Arë	2.100	2.100	321	674,100			-						105,100	779,200.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
5	Ndue	Pashk	Suti	2364	3/720/6	Arë	1,809	1,809	321	580,689			-						57,014	637,703.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
6	Vlash	Nikoll	Suti	2364	3/716/1	Arë	1,550	1,550	321	497,550			-							497,550.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 5.2.2020.			
7	Ndue	Pashk	Suti	2364	3/713/2	Arë	942	942	321	302,382			-							302,382.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 3.2.2020.			
8	Zef	Pal	Suti	2364	3/827-ND	Ndërtesë	104.43						-	104.43	27.863	2,909,733.09				2,909,733.09	Shëmbim	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
9	Dhimiter Mare	Ndok Zef	Trokthi Trokthi	2364	4/1578/ND	Ndërtesë	270.26						-	270.26	27.863	7,530,254.38				7,530,254.38	Shëmbim	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
10	Mark	Gjin	Zymaj	2364	4/634/1	Truall	3.375				3.375	1620	5,467,500.00							5,467,500.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 5.2.2020.			
11	Mhill	Gjok	Gjinaj	2364	4/802	Truall	750				750	1620	1,215,000.00							1,215,000.00	Kompensim në vlerë	Në proces gjyqësor, në seksionin E ka shënimin: "mbi këtë truall ka një ndërtim të paligjshëm".			
12	Llesh Preng	Pieter Ndue	Zima Zymaj	2364	3/397	Truall	1,228.50				1,228.50	1620	1,990,170.00							1,990,170.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, datë 5.2.2020, urdhër për vënien e sekuestros konservative datë 4.2.2014, Zyra Përmbanimore Kurtin.			
13	Llesh Preng	Pieter Ndue	Zima Zymaj	2364	4/634/2	Truall	265				265	1620	429,300.00							429,300.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020.			
14	Fran	Ndrej	Suti	2364	3/435	Arë + truall	348	248	321	79,608	100	1.620	162,000	60	27.863	1,671,780			93,590	2,006,978.00	Shëmbim për ndërtesën/dhe kompensim në vlerë për truallin dhe tokën "arë"	Konfirmuar nga ASHK-ja, datë 5.2.2020. Shënime në seksionin E: "mbi këtë truall ka 2 ndërtime të paligjshme dhe urdhër sekuestro nr. 793 dhe nr. 349, datë 15.7.2019. Përmbanues A.M.A.			
15	Pal	Ndrej	Suti	2364	3/386	Truall	200				200	1620	324,000.00	82	27,863.00	2,284,766.00			66,720	2,675,486.00	Shëmbim për ndërtesën/dhe kompensim në vlerë për truallin	Mbi këtë truall rezultoi objekt me leje ndërtimi nr. 4, datë 7.5.2010, me afat kohor deri më datë 20.5.2011. Plotësim dokumentacioni.			
16	Dod Zef	Vlash Vlash	Zymaj Zymaj	2364	3/396	Truall	520				520	1620	842,400.00							842,400.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, datë 4.2.2020. Mbi objektin rezultoi objekt ngritje 1 kat me leje ndërtimi nr. 5, datë 17.3.2011, me afat kohor 15.4.2012.			
17	Fran Gjok Gjin Llesh Mark Ndok Nikoll Preng	Ndue Ndue Vlash Pieter Gjin Vlash Pieter Ndue	Zymaj Zymaj	2364	3/398	Truall	412.50				412.50	1620	668,250.00							668,250.00	Kompensim në vlerë	Konfirmuar nga ASHK-ja, 4.2.2020. Mbi objektin rezultoi objekt ngritje 1 kat me leje ndërtimi nr. 5, datë 17.3.2011, me afat kohor 15.4.2012.			
18	Vid	Ndok	Prenga	2364	3/232	Truall	113				113	1.620	183,060	74	27.863	2,061,862				2,244,922.00	Shëmbim për ndërtesën/dhe kompensim në vlerë për truallin	Konfirmuar nga ASHK-ja, 13.2.2020. Në proces vlerësimi nga grupi i EKB-së.			
19	Tonin	Gjin	Lala	2364	4/1206-nd	Njësi	100.90										100.90			-	Shëmbim				



Kompensimi (lekë)/shkëmbimi (m²)								7,249.00	321	2,326,929.00	7,582.00	1,620	12,282,840.00	915.97	27,863	25,521,672.1 1	100.90	-	489,750.00	40,621,191.11	15,099,519 (lekë) / 1,016.87 (m²)		
NË PROCES LEGALIZIMI NË ASHK																							
1	Kostandin	Vlash	Suti	2364	3/1252	Njësi	37.38									-	37.38				Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020 ka shënimin: "kërkesë për përfshirje në legalizim, i pa futur në sistem". Në proces Verësimi nga grupi i EKB-së.	
2	Leonard	Lek	Trokthi	2364	4/1252	Njësi	123.00									-	123				Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020 ka shënimin: "aplikuar me dosjen nr. 2469 datë 26.9.2019, në proces skualifikim". Në proces Verësimi nga grupi i EKB-së. Plotësim dokumentacioni.	
3	Andon	Mark	Pula	2364	3/722	Ndërtesë	110.10							110.1	27,863.00	3,067,716.30				3,067,716.30	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "jo në proces legalizimi".	
4	Frang	Kol	Suti	2364	3/1250	Ndërtesë	159.90							159.9	27,863.00	4,455,293.70					4,455,293.70	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "deklarim me VKM-në nr. 442/2018, nr. 727 prot., datë 21.1.2020".
	Gent	Lek	Suti																				
5	Ndue	Pashk	Suti	2364	3/1251	Njësi	48.21										48.21				Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "deklarim me VKM-në nr. 442/2018, nr. 763 prot., datë 16.1.2020". Në proces Verësimi nga grupi i EKB-së.	
6	Kostandin	Vlash	Suti	2364	3/1253	Ndërtesë	135.93							65.49	27,863.00	1,824,747.87				1,824,747.87	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "deklarim me VKM-në nr. 442/2018, nr. 740 prot., datë 13.1.2020, me nr. 760 prot., datë 15.1.2020".	
	Martin	Nikoll												70.44	27,863.00	1,962,669.72				1,962,669.72	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "deklarim me VKM-në nr. 442/2018, nr. 759 prot., datë 15.1.2020".	
7	Ndue	Pashk	Suti	2364	3/1252	Ndërtesë	76.22							76.22	27,863.00	2,123,717.86				2,123,717.86	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "deklarim me VKM-në nr. 442/2018, nr. 759 prot., datë 15.1.2020".	
8	Zef	Pal	Suti	2364	3/826	Njësi	21.71									-	21.71				Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "kërkesë për përfshirje në legalizim, i pa futur në sistem". Në proces Verësimi nga grupi i EKB-së.	
9	Zef	Pal	Suti	2364	3/631	Ndërtesë	41.59							41.59	27,863.00	1,158,822.17				1,158,822.17	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "kërkesë për përfshirje në legalizim, i pa futur në sistem (aplikuar bodrum në objekt të legalizuar)".	
10	Anila	Tahir	Suti	2364	3/1254	Ndërtesë	248.00							248	27,863.00	6,910,024.00				6,910,024.00	Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020, ka shënimin: "kërkesë për përfshirje në legalizim nr. 4, datë 6.1.2020, i pa futur në sistem".	
11	Mikel	Ndok Zef	Trokthi	2364	4/1578	Ndërtesë	274.00									-	274				Shkëmbim	Me shkresën e ASHK-së, DV Lezhë, nr. 1341/L, datë 13.2.2020 ka shënimin: "objekt	

Fletorja Zyrtare Viti 2020 – Numri 26



Fletorja Zyrtare  Viti 2020 – Numri 26

[illegible]



41	Shtet	2364	3/718	Rrugë	2,647.00													-		
42	Shtet	2364	4/1206	Truall	335.00													-		
43	Shtet	2364	4/1211	Truall	33.00													-		
44	Shtet	2364	4/097	Truall	68													-		
45	Shtet	2364	4/1212	Shesh	169													-		
TOTALI PARAPRAK																			20,207,379 (leke) / 2,711.93 (m ²)	

Shënime:

1. Për vlerësimin e pasurisë së llojit "truall", çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
2. Për vlerësimin e pasurisë së llojit "tokë arë", çmimi i llogaritur është marrë me shkresën nr. 2135/1, datë 20.2.2020, "Kthim përgjigje", të Agjencisë së Trajtimit të Pronave.
3. Vlerësimi për kulturat bujqësore është bërë në referencë të udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000, "Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".
4. Për vlerësimin e pasurive të llojit "ndërtesë", çmimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, si më poshtë vijon:
 - a) me funksion "banimi" është bërë sipas shkresës së ASHK-së, Kurbin, me nr. 674/2, datë 6.2.2020;
 - b) me funksion "njësi socio-ekonomike", do të llogaritet me situacion, në proces vlerësimi nga EKB-ja.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë